



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 62, datë 24. 12. 2021

“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË HARTIMIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2023-2025 DHE TE BUXHETIT VJETOR 2023, TË BASHKISË SKRAPAR DHE INSTITUCINEVE NË VARËSI TË SAJ”

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 24. 12. 2021, pasi mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga grupi Menaxhimit Strategjik , në zbatim të ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, kreu VII-neni 33 –Kalendari Buxhetit Afatmesëm 2023-2025 dhe Buxhetit Vjetor 2023,

VENDOSI:

Që kalendari i hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023 të jetë sipas tabelës me poshtëme.

NR	EMËRTIMI	AFATI	ZBATUESI
1	Përgatitja e raportit për vlerësimin dhe parashikimin afatmesem 2023-2025 të ardhurave ku të përfshihet-Metodologjia e përdorur për parashikimin afatmesëm të ardhurave,-Analiza të efektshme të politikave të reja fiskale, analiza e risqeve dhe masat e marra për përballimin e tyre si dhe paraqitja e këtij raporti nga Kryetari Bashkisë në Këshillin e Bashkisë brenda datës 31.01.2022.	Brenda datës 31.01.2022.	Sektori te Ardhurave
2	-Miratimi i Raportit për vlerësimin dhe parashikimin afatmesem te ardhurave 2023-2025.	Brenda datës 28.02.2022	Keshilli Bashkiak
3	-Njohja me udhëzimin e përgatitjes buxhetit vendor dërguar nga Ministria e Financave dhe parashikimi i tavanëve përgatitore te shpenzimeve te PBA-se 2023-2025 .	Brenda dates 10.03.2022.	Dr. Financës dhe EMP-t
4	-Paraqitja e tavanëve buxhetore ne Këshillin Bashkiak per miratim.	Brenda dates 15.03.2022	NZ DEMP-t




5	Përgatitja e Projektdokumentit të PBA-se 2023-2025, dhe dërgimi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë	Brenda dates 01.06.2022	NA NZ EMP
6	-Shqyrtimi i raportit të rekomandimeve të dërguar nga Ministria e Financave, dhe përgatitja e projektdokumentit të rishikuar dhe dërgimi për miratim në Këshillin Bashkiak .	Brenda dates 30.06.2022	GMS
7	-Publikimi i dokumentit të parë të miratuar të PBA-së 2023-2025 .	Brenda dates 05.07.2022	G.M.S
8	-Përgatitja e taveve përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së dhe dërgimi në Këshillin Bashkiak për miratim.	Brenda dates 20.07.2022	-Të gjitha drejtoritë. -Institucionet e varësisë. -Nj.A
9	-Përgatitja e projektdokumentit të PBA-së të rishikuar bashkë me informacionin mbi rekomandimet e lëna nga MF dhe dërgimi në Ministrinë e Financave.	Brenda dates 15.09.2022	G.M.S
10	Shqyrtimi i rekomandimeve përfundimtare të dërguar nga MF, dhe përgatitja e PBA 2023-2025 dhe Buxhetit Vjetor 2023 , dërgimi në Këshillin Bashkiak për miratim.	Brenda datës 30.11.2022	G.M.S
11	Miratimi i PBA-se 2023-2025 dhe Buxhetit Vjetor 2023.	Brenda datës 25.12.2022	Këshilli Bashkiak
12	Publikimi i dokumentit të plot të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit Vjetor 2023.	Brenda datës 31.12.2022	Nëpunësi Autorizues

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Tatim Taksave

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 15 vota pro , votë kundër – s'ka, votë abstenim- s'ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .



KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI

